

BEGZAT RRAHMANI

**I ÇMENDUR
RRETH SHTËPISË**

I çmendur rreth shtëpisë

BEGZAT RRAHMANI

I ÇMENDUR RRETH SHTËPISË

POEZI

Kërçovë, 2002

Redaktor: **Kalosh Çeliku**

Recensentë: **Numan Limani**
Ahmed Mora

Lektore: **Gëzime Baftiri**

Foto në ballinë: “Mulliri Xha Halimit” – Zhubrinë
Autor i fotografisë: Agim Ramadani

Shtëpia botuese “FENIKS”

Botimin e financoi
z. Agim Iljazi – Kërçova
VIA SALORNO № 2
ROMË - ITALI

RRUGË TË ERRËSUARA

Pemët ndryshojnë frutat dhe shijen
lulet aromën dhe ngjyrën pranverore
prej kaltërsive qiellore bien copa akujsh
nuset humbin bukurinë dhe krahërorin e shenjtë
dashurija të fut frikën për jetesë në tokën tënde
rrugët të errësohen pasi te dielli të është shtuar urrejtja
të gjithë thirrin për mirëkuptim,
por pas shpine të ngulin thikën...

HESHTJE TINZARE

Në teh të malit bëra shtëpinë pastaj dhe varrin
ku rradhitën këngë e përalla të moçme guri
bukuritë shtoheshin me rreze drite e tinguj ngjyrash
mendja fundosej në mistere jete dhe dëshira të reja
si ëndërrat e lëna në udhëkryqe të ftohëta koke
si varri që si kalbë përrallat e kujtimet e gjyshit
pasi shpirti për herë gjen forcë për ngacmimet e kohës
që shpesh naj shtërngon gjokset dhe mendimet e kokës
si nata me heshtjen tinzare që vjen me plotë dhembje
natyre
kur vetë ngre kështjella në erë që të jeshë Zot i vetes
si shiu që i bie përmes errësirës për të njomur tokën e
bukës.

GURI SHTRAT VARRI

Shpirti kërkon rrënjët e gjakut
në trupin e varur të gjarpërit dëmëmadh
që dhembjet ja errësonin rrezet e diellit
duke u rrëzuar në gurin shtrat varri
ku me flakë gjarpëri shkatërronte kështjellën e gurit
kurse shpirti me thonjë gërvishte syrin e gjarpërit
për gjakun e trupit me rrënjë të derdhura
në tokën e zezë të shndërruarr në varre...

MBJELLJA E GJAKUT NËPËR DAMARË TOKE

Kujtimet e lirisë i ruajmë në shpirtë
pasi me errësirrën dhe vdekjen jemi mësuar
prandaj eshtrat i kemi të kalitura e gjakun të fortë
shpeshherë eshtrat na i kanë thyer e mishin djegur
por asesi shpirtin dhe gjakun e mbjellur nëpër damarë
toke

edhe sytë i kemi mbajtur në pëllëbë të dorës
dhe kemi vazhduar rrugën pasi rrezet e gjakut
kanë ushqyer dhe orientuar bebzat e syve
dhe në vapën e shkrumosur kemi shijuar aromë
pranverore

pasi nga ne ajri frymon jetë njeriu

- NE S’KEMI DËNIM PËR NË FERR –

HISTORIA E COPTUAR

Shpirti më shtryth lotët e kujtimit
për qiellin e trishtuar nga rebelët e kohës
që me organe fëmijësh rivitalizojnë pleqërinë
kurse gjaku i tyre i njomë shkruan historinë
e coptuar si zemra e qytetit pa njerëz
me varre të hapur dhe loket plotë uri
pa vajë, pa këngë, përplotë trimëri shpirti
si rrëkeja e kroit nga plasa e gurit
që lotët e shtrydhur i japin shije jete
me vite të kaluar por kurrë të mplakur...

STUHI MODERNE

Nëpër grillat e dritares shoh mure të hirta
kurse shtrati buzëqeshte me përbuzje misteri
për katër anët e botës dhe krimbin me gjuhë mistike
dhe çatitë e blozta nga helmet e paqta
ku lulet dhe mollët në degë vdesin në mëngjes
bashkë me kalimtarin e rastit si miza pa kokë
duke mos e kuptuar stuhinë moderne të kohës
që dikush e ruanë në sirtar të florinjtit
dhe sa herë që do e stolis zemrën shtazarake
së bashku me sadistët që i rrinë për rreth
duke numëruar varre fëmijësh në ëndërr
ashtu të lodhur grillat më këthejnë pamjen
nga trëndafili ngjyrë zjarri me aromë të shenjtë jete
duke i parë edhe fëmijët me kujtimin e lirisë...?!

URREJTJE PATOLOGJIKE

Kokat i kemi pasur të përmbysura
nga rrebeshi i shiut, copa akujsh të shkruimit veror
që na shtonin dhembjet te fëmijët e palindur
bashkë me prindërit që vdisnin sa herë që duhej
për pirësit e gjakut njerëzor si shushunja batakut
që tërë kohën e kalonin nëpër lulishtet e bareve plotë
pislleqe
me kokat e mbushura plotë urrejtje patologjike
duke harruar kujtesën e mësimave rinore
dhe shikimin e botërorëve për tokën kiklopijane
me mjeshtri gjarpëri dhe huti të pa parë karpatiane
mundohen ferrin tokësor ta paraqesin si Ylber paqe...

RINGJALLJE KUJTIMESH

Me djersën time ujitja shpresën e jetës
endërrat e tmerrshme i zhdukja në mëngjes
duke i futur në strajcën e harrimit të natës
bashkë me shenjat e lodhura të moshës
duke ringjallë kujtimet e bukura të largësisë
me fluturat nëpër lulet plotë ngjyra bote
ku shaloja rrugët me frerin në sy zemër e shpirtë
dhe trëndafilin që tërë vitit si vyshkej fytyra
si letrat e fshehura që më ruajnë kujtimet e jetës
që shpesh më lidhen nyje në fyt si kujtesë dhimbjeje...!

LABIRINTHI I JETËS MODERNE

Kujtimet s' mbaruan me kujtesën e vjetër
dhe largimin nëpër rrugën labirinth të jetës moderne
bashkë me topthin e dheut të mbështjellë në zemër
për të lidhur shpirtë e kokë me rrapin në mes katundit
ku thithej tymi sert e biseda shtruar plotë urti
që krejt rrugicat vinin aty si damarë gjaku
dhe shkrolat plotë vlera që mbulonin gurin e varrit
duke mbërthyer historinë e themelit tim
me dryrin çelik të dryshkur prej shekujsh
dhe si mëkatar për atë që mudohej të hapi
bashkë me deshifrimin e gurit plotë shkrola
që përherë qiriun na e fikte terri
duke menduar se sëmundja e pistë
kurrë s' do të ketë shërim për shkrolat e pa
kuptuara...???!!!

KËNAQËSIA E ÇMENDUR

I çmenduri kënaqet me pamjen e fytyrës së vet duke përjetuar lëvizje buzësh dhe kafshime mendimesh turrin s'ia ndal era as troku i kalit të zi për ëndërrën e bukur dhe dashurinë e humbur në fytyrën e vet plotë kujtime marrëzish për kënaqësi të çmendura në qiellin blu që rrudhet nga mjegulla për shiun e bereqetit por ato plotë kokrra breshëre që ia plasën buzët dhe pamjen e bukur të çmendurisë duke thyer pasqyrën e ujit të pistë nga mjegulla e trurit për kënaqësinë e çmendur të pamjes së vet...???!!!

DRITARET E MUREVE PA THEMELE

Në gurin e votrës hodha pleqërinë
në mendimet e zeza të kohës pa kufi
dhe trimëritë e lëna nëpër dritaret e mureve pa themel
për gëzime e hidhërimi në fushat e shkreta trishtuese
duke fajtuar të pafajshmit dhe moshën që erdhi pa ftuar
për famën vrasëse dhe mendimet pa fije shprese
për kokën pa kulm dhe qiririn e harxhuar në mungesë
si akulli i dimrit të egër në tehun e malit nga rreze dielli
dhe shkrirja e trupit nga pleqëria e hudhur mbi te
në kujtim kënaqësie për votrën e lindjes...

KTHINAT TRURORE

Të vdekurit ruajnë mendime të gjalla
ata i ruajnë ndodhitë e gurëzuara në kokë
të gjallët turren pas tyre me hamendje marramendëse
për të nxjerrë kajmakun që gjarpërinjt e bolla kanë bërë
gosti
dhe lirisht marshojnë nëpër kthinat trurore të kokës njeri
prandaj çdo gjë është e mundur por dhe jo trurit të
harxhuar
aty në kthina fillon e mbaron profecia njerëzore
me gjygjim për mendimet e të vdekurit
duke mallkuar varrin me emër për jo rehati
dhe zënkat me aktakuzat e mosdijes shqetsuese
mallkon truri i bërë nevojë gjarpëri për shkarravinat në
letër.

JETA MESKINE

U ktheva që ta hedh hakmarrjen që e qava në rini
bashkë me librat e vjeshtës dhe ata që kalben pa faj
dhe lajmin që e mësova i pari nga plumbi i armës akull
me trishtim si det i hutuar me piktura vdekje
për jetën meskine të ditëve të mia dhe atyre përpara
duke ngujuar të qeshurat rinore me trishtime dashurie
me ndërrime vendesh si statuja të kuqe parqesh
pasi edhe zogjtë e qiellit s'lejnë rehat të prehesh
për jetrat e shuara të kohërave meskine...???!!!

OAZA E GRILLOSUR

Aty ku mungon kryefjala këndohen këngë misteri
dikush ec pa kokë kurse tjetri s'njehë vetveten
porositë vinë me kujë nga tutorë të pa autorizuar
që rrugët e jetës i mjegullojnë si ujqët me ujit e turbullt
pa gjurmë burrërie për ligjëronjësën e ëndrrave sterile
duke rrahur gjoksin brinjë kalbur si brengë kryefjale
për baladën plotë stoli dhelprake për oazën e grillosur
duke dashur t'u thejnë flatrat e atyre që duan tokën e vet
sa jetën dhe varret shekullore duke thurur vargje të
zjarrëta
për foletë e gurta plotë fëmijë dhe kurrë të braktisur...

LËNDIMI I YLBERIT NË QIELLIN BLU

Çmenduria njerëzore për luftëra në kohëra të pacaktuara
në vende të rrebeluara për pushtet majtist në kohën e
djathhtë

me gjësim tokë dhe futje frikë në zemrat plotë mllef
duke futur urrejtje në besim dhe rrënim të asaj njerëzore
si barbarët robërues në vende të huaj që vetëm ata
shajnë Zotin

dhe dinë të bëjnë përçarje me dredhi djallëzore
për trupin e lënduar bashkë me ylberin e qiellit blu
urrejtje këthehet në katarzë në lulishten e Oazës
vrasëse...

MARRËVESHJA ARA-MARA

Nënshkrim për marrje shpirtërash në kohën e luleve
kur krushqit këndonin himnin e poetit të vdekur
bashkë me luftëtarët e lirisë të lidhur në pranga
duke ua prerë gishtin e pushkës dhe qitur syrin e
nishanit

Kodrën e Diellit e mbuloi gjaku i borës së zezë
me marrveshje të kuqe të autodidaktëve në Lihnidë ara-
mara

dhe me gojë e duar të lidhur për dy jetra njeriu
vdekjet e bardha të murosurat në kohën e zezë
nga zvarranikët dhe mjekroshët me pisllek shpirti
me dhembje shpirti e shprese presim shekullin tjetër
ndoshta piqet truri i lisit me degë shumë...???!!!

VDEKJA E MESJETËS

Janë mërzitur të kuqtë për vdekjen e mesjetës
pasi fjalët e tyre kan humbur drejtimin e erës
çdo njeri është këthyer vetvetes me sy kokë e këmbë
secili ka rrugën e vet pa influencë e drejtim ere
ata thinjen e ngelin pa flokë por vdekja është vdekje
lëshon rrënjë zie edhe pse varri ngel i zbuluar
për t'u parë ndytsira e kuqe me veset e mesjetës
në qendër të Ballkanit me civilizim të rrejshëm...!

ESHTRAT E GJYMTYRËVE TË SKALITURA

Nëpër udhën e gjatë të jetës labirinth për dijëni nga libri
i moçëm
amanetin e gjeta në gurin e varrit të tokës së robëruar
nëpër eshtrat e gjymtyrëve ishte skalitur fjala e shenjtë
besë
dhe një kokërr kripe e dalur nga zemra bënte roje sigurie
tepen e shoqëronte një lule së bashku me rrezet e
përgjakura të hënës
që eshtrat e skalitura i jepnin kurajo lules në tokën e
robëruar
bashkë me librat e moçëm që ruhen si gurë varri për
robërinë...!

THONJË ËNDËRRASH TË PRISHURA

Mbi krahë të eshtrave të thyera na peshojnë carranikët
zemrat na i gërvishën me thonjë ëndërrash të prishura
nëpër dhoma varresh të errta e të mbërthyera me grilla
derisa gjaku ngrinte në damarë pa shenjë jete trupi
carranikët na i vëndonin si shenja frike për jetë të
vdekur
për trupi na shndërrohej në feniks me avull zjarri të lules
mbi varr
me rrënjë të thella e të vjetra sa edhe vetë toka...

URA E GJATË SA VETË LUMI

Jeta më thotë nisu nëpër terrin e natës së gjatë si lum i
qetë
kur valët qetësohen nga rrezet e hënës së plotë me yjet
valltarë jete
mendimet thellohen në kurora lulesh me ngjyra
fluturash fëmijërore
ura e gjatë sa vetë lumi lidhë zemrën e tokës shpirtë të
bleruar
me erën e fladëshme nata shtrydhë kujtime vuajtjesh të
tokës së copëtuar
duke peshuar fatet nëpër valët e tërbuara të lumit tash të
vërshuar
që më vetë ka këputur prangat dhe ngjitet nëpër bregun
e lirisë
me këngët e valëve të ngjitura në shtizën e flamurit
plotë kujtime jete
si flutur e bukur me ngjyra gjallërie të pranverës plotë
rreze dielli.

DJEPI VARR DHOME

U shterë shtrati i gruas me dryrrin e derës në gjumin e
rëndë
kur në malin e thatë era palonte ëndërrën e flokëve të
gjata
fluturat luftonin me mizat e mërzitshme si pupla zogjësh
nga huta
mbi djepin ku fëmija i trembur hapte e mbyllte sytë me
lot të përgjakur
duke kërkuar nënën në cepin e dhomës te shtrati i
shterur
bashkë me buzët e fëmijës që djepi ishte bërë varr
dhome
me pikat e fundit të gjakut që vinin në zemër si thika
vaji që shterej bashkë me luftën e flutrave
dhe korbën e murosur si legjendë në gjumin e rëndë...!

SY XHELATI NË PËLLËMBË DORËS

Në dasma fëmijësh hapnim varre në oborre të shtëpive
pa pikë faji
të mbërthyer si në shkretëtirë në mes të ujqish drenusha
e vetmuar
gjakë e shpirtë bëheshin shkrumë për durimin e natës pa
fund
ky lëmsh dhembjeje trazonte edhe zemrën e kalit që
priste për shalim
shumë herë plaku i urtë kishte treguar varret duke
kërkuar rrugëtim
shikimet tallëse thellonin plagët në trupin e moçëm sa
malet te plaku
duke i erdhë një fuqi toke si vetëtima për dy sytë e
xhelatit
që i mbante në pëllëmbë të dorës duke dhënë shenjë për
mos durim...

DHËMBË OKTAPODI

Piratët e hutuar shkatërruan ëndërrat e fëmijëve
me oborret e palmave të bukura me rrënjë të lavdishme
duke i derdhur ëmbëlsirat në detin pa fund me pamje
arkivoli
me lojën pirateske u shemb edhe kulla e vdekjes nga
deti
duke i ulur vallët e pikllimit nga rrezet e diellit të
plagosur
në horizont u zhduk ngjyra palmë nga dhëmbët e
oktapodit
shpirtërat iknin në qiell për t'i shpëtuar martesës vdekje
nga piratët oktapodë që prishin ëndërrën fëmijërore...?!

NDËRSYESI QEN I ZGJEBOSUR

E rëndë është fyerja kur të bëhet i mbërthyer në grilla për të jetuar në gjumin e vdekjes nga ndërsyesi qen i zgjebosur nga lavire shërbëtore e kuqe me punë mortore për kombin që të vërtetën e kërkon te sunduesi me shkarravina gjo të lashtë duke mohuar burimet e pastërta për historinë e gjallë me pasqyrën e thyer të gjakut pa ndërgjegje të ngrohtë zjarri lojat e çuditshme për vdekjen e pasardhësve për famë qeni duke dashur përjetësi te sunduesi me vdekjen akoma i pa lindur të këthen të mendosh se qentë shpesh të kafshojnë në besë...?!

SHPRESË DIELLI PËR SHI NË TOKË

Këngët e vdekjes zhduken nëpër shkurret e dimrit të egër
që ngrin tytat bashkë me hundën dhe gishtin e pushkës
duke lënë zogjtë të lirë në territorin e vet qiellor
deri dje të grisur në pjesë – pjesë me idenë e vdekjes në kokë
dhe sy gjysëmhapur në kohën mistere duke parë botën
në pëllëmbën e çarë të dorës me shpresë dielli për shiun
në tokë
dhe mbarimin e dimrit me luleborën në rrugë për drejtësi
duke zëvendësuar strofkat nën shkurre me dhoma miqësh për bisedime
për dritën e jetës në botën e civilizuar me jetë të buzëqeshur?!

DJEPI I GURIT

Nën rrotën e historisë thehej njëri akrep i orës
me rrugën e coptuar qysh me rrezet e para të diellit
që lëkura e trupit kishte thyer kamxhikun e irur të
kohës
duke mos e lënë të këthehet errësira si rufe e gjakosur
me humnera të avazeve të moçme nëpër kulla me
mospërkulje
shumë herë të flakosura por kurrë këngët të zhdukura
me forcë e shpresë për mure të reja e me udhë më të
larta se harku
ku djepin e gurit më s'do ta shkundin erërat e hutuara e
pirate
duke ua tharë rrënjët dhe thyer edhe akrepin tjetër të
orës...

HIRI I TOKËS SË VAPOSUR

Sofra e drurit e madhe, por buka e vogël
për duart e plasaritura nga shkrumi i tokës
që na mbante gjallë me një ëndërr lirie
në stinën e punës që zgjatëte një vit
së bashku me durim-zemrimin si heshtje varri
dhe fjalët e derdhura nëpër tru, dhëmbë e plandës
si pikat e ujit që vadisin hirin e tokës së vaposur
të stolisura me ëndërrat e lirisë për sofrën e madhe
por gëzimi zhdukej me shtrydhjen tinzare të qenies njeri
pasi bota na qenkanjë kozmetikë kujtimesh shterpe
për lumturinë e zemrës të bukës së vogël në drurin
sofër...

HIEROGLIFE TRURI

(Dr. Hasan Kaleshit)

Eshtrat e vetmuara në tokën e huaj
plotë idhësi nga hieroglifet e trurit
që ia shtrydhnin për dëme të sojit të vet
por ai me kokën lartë përmbyste idetë ideoteske
duke i zbardhur qimet e kokës një nga një
si të rrahurat e zemrës përpara drekës së dyshuar
me dashuri të madhe e plotë dhembje për Sajon
dhe gjakun e derdhur nëpër botën e shturur
ku shpenqja ia prishte ëndërrat në gjumë
nga instruktorët e kryqeve me shpërblime marramendës
për kopilin qen veshë paprerë në tokën e shkrumosur
që vargonte goditjet e rrufeshme pas shpine
me korrespondentët plot urrejtje patologjike
për trurin e lindur nga gjeni i pastër
në vitet e rralla të tokës nënë
ku vetëm ajo tokë e vendëllindjes do t'ia qetësojë
eshtrat...?!

URREJTJA E DRYSHKUR

Shpirti i shkëmbit u bë shkrum
u skuq mali, lumi dhe qielli
dielli shkoi të perëndojë para kohe
i hypur mbi kalin e lodhur nga hija e zezë
që ia ziente frymën dhe rrugën e lindjes
zembrën ia dërrmonte gjaku i shkrumosur
nëpër damarët dryshkur të urrejtjes
që me dredhi i hynim në barkun e shpirtit
që prej kohësh i ka bërë dëme në këtë nënqiell...

RINGJALLJE ESHTRASH

Toka e tharë plot shkertëtira të kuqe
korba e gjarpërinjë cofin bashkë me katilat njerëz
përllumbat lajmëtarë u varguan për në perëndim
ca fiye bari dhanë shenja jete mbi tehun e malit
ku mbi varre ranë ca pika shiu për ringjalljen e eshtrave
shkretëtirën e kuqe e mbuluan shtëpiza barinjësh
ku fëmijët në llapusha mësonin germat e jetës
kurse këmbët e z bathura ua shtonin dashurinë për tokën
bashkë me kallot e gjakosura drejtonin ardhmërinë e vet
me plagët e rrsura në eshtrat për ringjallje...

TRURË VIGANËSH TË COPTUAR

Gjymtyrët e viganëve ngelën në arenën e luftës
kurse trurët e coptuar në tavolinën e bisedimeve
sipas regjisë së strategut miop të kohës
që lirinë e shikonte nëpërmes eshtrave të coptuara
për yjet dekor të gjoksit mushkëri kalbur
i rritur në kohën e kuqe të idesë mizore
ku për ëndërat e trilluara shpërbleheshin me errësi
nga rodi arian i trurëve viganë të kalbur
për t'u afruar si maçorrët rreth tryezës vrasatare...?!

VARR NË THE TË MALIT

Stina shëronte plagët me hirin e pjellës së vet
tjetra ia merrte lulet që i përgadiste për vdekje
gjinkallat e lodhura e të përgjakura në mes të ditës
vajtonin lulet kurorat që u hapej varri në tehun e malit
duke trazuar këngët e shpirtit në stinët e lënduara
si vargjet e jetës që më ngulen si thika në zemër
bashkë me hijen e zezë që edhe katragjyshit e kanë
trazuar
ashtu me gjymtyra lulesh sillem si i çmendur rreth
shtëpisë
duke iu lutur gjinkallave që të vazhdojnë muzikën e
jetës
që të gatuaj ëndërrën e bukur në mes të ditës
me stinën e vitit në varrin e tehut të malit...???!!!

YLLI I LIRISË

Plumbat e siluetës shurdhoin
dhembjen e zemrës dhe mushkërive të thinjura
duke turbulluar mendjen e kohës në tavolinë
me hijen e zezë dhe të gjatë
që askush s'dinë qëllimin e gjakut që derdhet
as fjalën e madhe që i thonë BESË
kurse ai ruante trurin dhe gishtin në kamëz
duke menduar për lirinë e gjakut nëpër damarë
dhe tokën që digjet për Yllin e lirisë
bashkë me shpirtin e shkëmbit shkrum
që shtrydhet me kujtimet e vdekjes
si druri që humbi gjallërinë nga plumbat rebel
por kurrë s'humbi guximin shpirtëror
dhe rrënjët e thella që e mbajnë vertikale...

SHPIRTËRAT E LËNDUAR

U rrasëm me këngë trimërie vajtime e dashurie
dhe me plagë në zemër të luftës, kurbetit, burgut dhe
krenarisë
frymë dhembje e tragjedisë së zezë me varre të hapura
ku mirësinë na e shkruanin si mëkate me kërtilje
që kurrë të mos harrojmë shpirtrat e lindur në shtëpinë e
vjetër
durimi vyshkej si lule e vdekur duke ringjallë zemra
trimash
me plakun në ballë duke shpaluar histori trishtuese
për oborrin plot rrugë pezhishke me ecje hijesh të
padukshme
çdo udhë për në kulm përgjakej me
këngëshpendkeqje...!

GOFI I MOSHUAR

Nëpër ëndërra përmallem
me mësuesin e thinjur
para kohe të vendlindjes
kur një gur ia dërrmonte trurin
kurse ai frikën dhe përkuqjen
i fundoste në greminë pa fund
duke shkatërruar hartime planesh
të atyre që thonin se janë pushtet
me thinja rinore dhe Gofin e moshuar
kapej fyta fyt për ne
nxënësit e shkretirave të kuqe
ku vdekja vinte duke vajtuar
si re stuhie të shiut rebesh
me rrufe e vetëtima djegëse
nënat na i vishte me të zeza
për të ikur ne jasht kufirit...

NDËRRIM GJENERATASH

Kthimi kryebardhë i kërrusur dhe tullac
me moshën mbi krahë drejtë rrugës pa kthim
dashuria e atyre që takova, ndërrim gjeneratash
si krongjitë e lëshuara gjer në tokë
që me shkrirjen e tyre shkrihej edhe më shumë dashuria
nëpër rrugët e ngushta njerëz me bastume para kohe
që më dukeshin shkret me zemra egërsirrash të pa
dukshme
ku mjegulla kap për fyti e të shtryth gjakun
bie në gjunjë e thirrë vdekjen, ajo ik si prej gjarpëri
buzët të piqen, shpirti të vjen në majë të hundës
a ti vazhdon rrugën përmes shkretirës së egërsuar...

RELIKTE PORTRETESH

Nëpër retë e larta pres perënditë ilire
bashkë me ngjyrën e kuqe zjarr dhe shqiponjën në
fluturim
me amanetin e maleve dhe grushtin e tokës fushore
që breg më breg të lumit e detit kokë e sy s'kanë qetësi
duke mbëledhur relikte portretesh të kalendarit arkaik
sme shikimin e qenve plotë kujë për arritjet shkencore
dhe qiraxhinjt e sojit të mushkave duke vrarë zogjt
këngëtar
duke shpërndarë kallkan për orakullet ilire
me shpatën vrarëse për shpirtin e pastër të
trashëgimtarëve ilir...

VARRE PËLLUMBASH

Nëpër damarë rrjedhë gjaku si lumë i rrëmbyeshëm
që ti bëjë ballë shtypjes së krahërorit nga rrebeshi i
kohës
që dëshiron për palce ti fusi trishtimin e egër
me etje uri dhe pranga robërie për pëllumbat e bardhë
trimëria dhe shpejtësia e rrufeshme ia këput trupin si
bollë
acarit gjarpër karpatesh që vendos mure në tokë të huaj
duke ngushtuar tokën e bukës për varre pëllumbash
pa mos e parë se vajin dhe shqetësimin ia shton
vetvetes...

DIELLI NË MUAJIN E ACARIT

Zogjtë fluturojnë krahë hapur përmes kanonadave
me trimëritë e luftëtarëve të lirisë nëpër shkropa
që retë formonin fusha pjellore për bukën e luftës
shkëmbinjtë thërmoheshin në gjellë për zhdukjen e
vdekjes
me lindjet e diellit në muajin e acarit të shumë pritur
për ata që mbjellin pikllim në heshtje nate
duke pirë kafënë e mëngjesit ëndërrojnë zaptim tokash
me përralla trilluese plotë akuza për pronarin e moçëm
pasi të çmendurëve ua lanë pushtetin autoktonët
tash u tregojnë vjetërsinë e të vdekurve dhe të
lindurve...

KULLAT E GJAKUT

Zjarri na forcon gishtin e pushkës
për përrallat e përvetësuara nga muzeu i dhembjes
bashkë me kafkat plotë ajkë të pastër
ku nëpër sinorin e tokës kërkon gjymtyrët e sakatosura
që është bërë galeri me plotë mrekuilli mbi shkrime
varresh
me bozhure të kuq gjak dhembje ku shqiponja bëri fole
për besnikërinë e luftëtarit plotë rrudha nën lisiin
shumëdegësh
ku me trimëri e mençuri ndërtoi kullat e gjakut
por muzeu i dhembjes bëhet hije për kullat me themele
gjaku...?

KOCKAT DËSHMITARË KOHE

Ai gisht i koalicionit të dogji palcën në asht
duke humbur kokat më të mira të të parëve
në tavolinën e bisedimeve të vendoi koka acari të
retarduara
që rrënjët e damarëve i kanë prerë e sakatosur shumë
herë
si rrufe varresh të djegur me xhevahirët dëshmitarë kohe
duke na zhdukur nga fjalori fjalën e bukur dashuri
atdheu
juve që ua dogji palcën ua zgjoi epshet për dominim të
gjakut
me vrasjen e trurit për ëndërrat e natës nëpër bordele
karpatesh
duke ua futur aromën e vdekjes nëpër shtëpitë e juaja të
lindjes...

GJUMË I GURËZUAR

Mileniumin e gjatë e kaluam në gjumë të gurëzuar
si mjegulla të vetmuara nëpër erërat e hutuara
në qiellin pa fund të shekullit të kaluar si yll i shuar
në ujëra të kristalta duke pritur shpirtin Feniks
dhe gjuhën e harruar nëpër motet e stuhive rrebeshe
e mbështjellë me lëkurë dhelpëre të gjumit të gurëzuar
duke ëndërruar vrrasjen e gjarpërit në shtëpinë
stërgjyshore
por ai u bë Qiklop i tërbuar me flakë të zezë nate
që erërat e tërbuara i këthente në gjumë të gurëzuar...?!

GISHTI I MADH I KOALICIONIT

Tavolinat i zbukurorin me buqete të kuqe me pika të zeza
duke u shkuar truri vërdallë në darkën e tradhtisë
kur gishti i madh i koalicionit u bë shkop gome, vrastarë
si dikur gështenjat vrasëse të tokës së kripur
me burrat andej kufirit që kishin humbur fjalën vëlla
duke ua dhënë besën atyre që kanë gjak gjarpëri
karpatesh
darkat e tradhëtisë i dehën pasi s'punuan me trurin e vet
shikonin para trupin si kali rrugën e karricës plotë barrë
duke mos parë gishtin e madh të koalicionit në
prapanicën e djegur.

VARRE NË PËLLËMBË TË DORËS

S'na vlej në mirënjohjet me varre në pëllëmbë të dorës
me ndytësira të asociacioneve politike në fytyra pleqërie
zemrat rinore të mbërthyera me grilla çeliku në bordele
me roje vrasëse të proceseve të montuara ushtarake,
antinjerëzore
duke qarë për dashuri ushqimi në dritaret e vdekjes
me namë shpirtërash për trupa të mbështjellë me helm
që zhdukin jetën e tokës për varre ushqime bollash me
flokë
adhurues të mëdhenjë të vajit e errësisrës me lotë të
tharë dielli
nëpër natyrën e dhpirtit të bukur të dejur me vdekje...!

PIKLLIMET E GROPOSUR NË ZEMËR

Në labirinte të errta idetë e tyre i kemi qirinjë drite duke grisur pezhishkat dhe pikëllimet e groposur në zemër

ku flaka e ngrohtë rrënon stuhitë e heshtjeve dhe harresat e varreve të pa shkruar në letër lodhjet e labirinteve të errta s' shuajnë idetë e tyre ata zgjojnë dëshira jete e tokë për oxhaqe e varre ne urrejmë vetminë fëmijët na sjellin aromë lulesh si gerrat e skalitura që na e zgjasin jetën e shkurtër nëpër labirintet e errta dhe fjalët e egra të shtrigës së kuqe?!

DËNIM VARGU

Vargu është i dënuar me vdekje si i burgosur kohe
me vetmi nate, vaji të heshtur dhe si mëkatar vdekje
duke shkukur zemrën për në udhën e largët të natës
ku edhe hënës i bënë hile duke ia lidhur sytë për
orientim
me mallkim për rrugë plot dhembje të kryqëzuara
duke mbjellë fjalë pas lotit aromën ndoshta dikur për
këthim
trurin e coptuar të mbledhur në dashurinë e tokës
për këngët e paharruara me dënime burgim të
përjetshëm
dhe mallkimin e nuses në shtëpi të burrit varr burgu...?!

FORTËSI GURI

Me ngjyrën e mushkërive lagim kafshatën e gojës
duke thyer gurë me natë që misërnikja të ndodhet në
magje
udhëtimin maraton duke numëruar lulet e agimit
me djersën e gjumit plasim djallin që na ndjek si hije
duke xhelozuar në fortësinë tonë prej guri
dhe mjeshhtërinë e përdorimit të veglave dhe të armëve
syri përherë i lodhur nga padrejtsitë e pushtetit të egër
përherë të akuzuar si rebelë prej akuzave të kuqe
derisa një ditë akuzat marrin zjarrin e durimit...?!

RRUGËT PLOTË DHEMBJE

Natyrë ka nevojë për ngjyra të piktorit
për lule të bukura sipas dëshirës së fëmijëve
që të zhdukin helmetat dhe gjakun e gurëzuar në piktura
vdekje
me ca libra e fletore sikur të rritur para kohe
këngët e lumenjëve ti mbështjellim me gjelbërime
mendimet ëndërra të zgjuara të ndryshojnë jetën
si zogjtë nga lartësitë e qiellit duke parë pikturat e
natyrës
dhe kurrë në lojë mos ngelin të vetmuar si qyqet në lis
duke ruajtur përrallat stërgjyshore të rrugëve plotë
dhembje...

UJËVARË LOTËSH

Stuhitë e motit na u bënë ëndërra të gjata
duke na u bërë këngë morti me pak dritë gjaku
me relikte të amshuar në ujëvara lotësh krenarie
për djemt që bënë dashuri dhënduri njënatëshe
pastaj fluturim me amanet shpresën dhe koburen në brez
tu bëjnë ballë rrebesheve të kurdisura nga ëndërrat e
gjata
për vallen vuajtje dasme që mendonin se kurrë s'ka
mbarim
sofrat përherë i shtronin, por kurrë si këthenin në vend
pasi na ngacmonin zjarrin, shpirtin dhe vatrën tonë të
lashtë...

TRURI ME BËRLLOG TË PISTË

Unë i njoh njerëzit që duan kulla letre për të tjerët
po t'ua shpalosh zemrën ua gjenë acarin e tradhëtisë
ata trurin e kanë të mbushur me bërlllog të pistë
sytë e tyre përherë shohin errësirë mallkimi e loti
lumturia e tyre është si shporta e zbrastë tregu
gjysmën e natës e kalojnë në ethe hallesh të montuara
në vetmi rrinë kokulur me peshë të rëndë mali
në shoqëri fluturojnë si galat nëpër shiun e furishëm
pra jeta e tyre është një labirinth në kullën plotë halle.

KËNGËT E MBËRTHYERA

Dorëshkrimet i ruajtëm në strajcat lëkure prej toke
të qepura me halle të rinisë dhe shpirtrave stërgjyshore
me histori themelesh të depove me plotë thesarë
mileniumesh
të fortunave arqitekurore me kala eshtrash të përjetësisë
nga vdekje trimash për hallet dhe shpirtrat e shqetsuar
për këngët e mbërthyer në kurora malesh pa gjelbërime
me ballo lugetrish të përsëritura herë pas here...

FYTYRA E SHTRIGËS ME HELM GJARPËRI

Nëpër rrafshë shkretëtirash dhe mjegulla të errëta qielli
kërkoj të kaluarën e mallkuar me rrënjë zie e lot mjerimi
për rrugën e trasuar me gjak për trimëri vëllavrasëse
me fjalën e thënë ters bie në ngatërresë për realitete të
vyskura
dalëngadalë duke kthjelluar mjegullat e errëta kthjellon
realitetin
hynë në botën e gjelbër duke zbuluar fytyra shtrigash
me helm gjarpërinjsh
prej rrjedhës së pastër duke shpërlarë trurin dhe syrin e
shtrembëruar
për rrafshin e shkretëtirës dhe fytyrën e vërtetë të
shtrigës nxitëse
duke qetësuar shpirtin kuptojmë këngët e pa
kënduara...?!

UDHËKRYQET ME HISTORI TË ZEZË

Në çdo udhëkryq ka një dru ndoshta edhe pemë
për orientim si busollë me histori të shkruar, më tepër e
zezë
duke kërkuar kohën të përshtatshme me shi ose mjegull
ujku
atëhere gjaku shkonte rrëke atëhere shqiponjat
mallkonin foletë
tuli i shkrirë shkruante historinë kurse eshtrat
dëshmonin
krimin në udhëkryq
djalli fshinte gjurmët duke thënë ia arritëm qëllimit unë
jam
pas teje
duke nxitur historinë e zezë të lëshojë rrënjë të thella
të mbështjellë me pezhishkën e gjakut të mallkuar
në këngët e gjata të udhëkryqeve me histori të zezë...

BORDELET E VIKENDEVE VRASËS

Edhe unë isha i pa njohur si varri i ushtarit mermer i
ftohtë
prandaj ai më kuptoi kur recitova poezitë e Çajupit të
madh
duke u betuar se më kurrë s'do të mirrja – FIKS
VAKSINA –
dhe kurrë s'do të më mirrte malli për përjetime
leshatukesh
për çastet e ëmbëla në bordelet e viktimave vrasëse
të metropolës varr për kombin t'im të shumë vuajtur
duke bërë llogaritë me trenin e fundit për në fortesën e
vuajtjeve
me ofendimet e grumbulluara prej kohësh si
qeleshëbardhë
thash kurrë më këtu duke lënë shëndetin e rinisë në
bordele...

AKREPAT E DIELLIT

Drini tregonte rrugën e lodhur me shpresa pa fund
për portën e lashtë me aortën e jetës si Zot i vërtetë
duke u rritur si ushtar i karavanit të kripës nëpër shkrepa
me natën e verbër dhe me vallen e këngëve të zogjëve
trima
që të ringjallin dashuri jete bashkë me burimet e gurëve
të vjetër
me akrepin e diellit në lindje dhe të hënës në perëndim
duke i kryqëzuar rrezet kurora në zenit për dashuri të
përjetshme
kurse karavani me valët e thinjura të Drinit i afroreshin
Durrahun
për njohuri në tregtinë e vjetër të rrugës Via Egnatia...

SHKRIM PËRJETËSIE

Yjet e natës derdhen nëpër trurin e njeriut enigmë
me bukurinë mahnitëse të përallave që zbresin ngadalë
pa lëndime
duke mos u plakur kurrë në rrugën pa fund si shkrim
përjetësie
që kurrë s'don ta shikojë botën si anije e coptuar në det
bashkë me hijen e njeriut robot që krejt e ka në
pëllëmbë të dorës
me kujën e lodhur në trollin e mjegulluar të natës së
madhe
duke kërkuar dritën e derdhur nëpër vërshimin e
enigmës tru
si metal i gdhendur që miklohet nga mendime
profetike...

PORTAT E HAPURA TË HORIZONTIT

Fëmijët janë heronjë si pëllumbat e qiellit të pastër
kur s'mendojnë për helmin e shpirtit nga hiri tradhëti
akulli

me buzë të njoma puthin bukuritë që ua sjellin sytë
nëpër portat e horizontit të hapur me kokë e fytyra të
stolisura

duke kënduar këngë për rritjen e tyre si rritej lulja
ku ninullat i çojnë në sarajet mbretërore për vashat
ngjyrë molle

valët e shqetësuara i ndalin me buzëqeshje fëmijërore
ëndërrat vrastare duke ua dhënë qenëve të zgjebosur
për të vazhduar këngën nëpër portat e hapura të
horizontit...

GJAKU I ORAKULLIT TË DJEGUR

Në krahë të dallëndyshes i vëndova vuajtjet e popullit
bashkë me flamurin e ndaluar që magjeps me rrënjët e
lashta
gjakun e orakullit të djegur nga ngjyra e zezë të flakës
ëndërr
me dridhje të çuditshme rrezesh për zhdukje pejsazhi e
rrugësh
të ngjyrosura me kob populli nga fati i kokave të
vjetëruara
me tërbime të friksuara për shenjat e foleve të vuajtura
që i shikonin yjet e panumërt në krahët e dallëndysheve
trime
duke ndjer pikëllim për vuajtjet dhe krahët e lodhura
nga ëndërrat rrena të pasura me rrugë të gabuara jete...

VAJTIM I ZOGJËVE NË FLUTURIM

Peshimi i fjalëve fortëson gurin e themelit historik
duke u ngjitur jetës përpjetë nëpër rrugët e rënda të
kohës
me kryqëzime shpatash për mendime pasurishë
antinjerzore
me katarakte gjaku që mbushet qielli e toka me lot e
plagë
që sa herë kemi parë sy e zemëra fëmijësh të rënditura
në karikatorë
duke i vajtuar zogjtë lartë në qiell rrugët e tyre pa kthim
për prangat e fjalëve në themelet e shtëpive me histori të
rrënuar...

GJAK E SHPIRT TË PËRZIER GJALLESASH

Krijesa e lumtur me gjak e shpirt të përzier gjallesash
nga ylli prej atje larg mori errësirën shfarosëse
për pasuri të shkujdesur me shenja vdekje treti
lumturinë
me shpirtin e gjakut tinzak ia kalon bishës me terrin e
gjallë
me gërvishje të mundimshme mbulon krimin si macja
nevojën
dashurinë e mbuluar e vret si rrufe e zezë me këngë
solemne
edhe pse i vetëdëshëm se bukuria dhe mençuria
shndërrohen në hi të përjetshëm...?!

**Bibliografi tematike dhe kronologjike të autorit Begzat
Rrahmani të botuara nëpër gazeta dhe revista të shtypit
periodik**

I. Poezi për të rritur

1.	Në pritje	Jehona 3/4	Shkup	1986	f	133
2.	Dy lule mbi varr	Jehona 3/4	Shkup	1986	f	133
3.	Ti dhe deti	Jehona 8/9	Shkup	1987	f	133
4.	Jeta e fshatit	Rilin. 10.01	Prishtinë	1988	f	13
5.	Sofra e vjetër	Rilin. 07.02	Prishtinë	1988	f	13
6.	Vjetërsia	Rilin. 24.03	Prishtinë	1988	f	13
7.	Trupi i vargosur	Rilin. 24.04	Prishtinë	1988	f	11
8.	S'është e mundur	Rilin. 05.05	Prishtinë	1988	f	11
9.	Njerëzit të mos bëhen ferra	Jehona, nr.4	Shkup	1990	f	73
10.	Moti ishte i ashpër	Jehona, nr.4	Shkup	1990	f	74
11.	Jeta	Fl. v. 17.05	Shkup	1991		
12.	Viti 2001	Fl. v. 17.05	Shkup	1991		
13.	Eshtrat bërtasin	Fl. v. 17.05	Shkup	1991		
14.	Shokët e përqeshin	Fl. v. 27.05	Shkup	1991		
15.	Nata e madhe	Fl. v. 20.12	Shkup	1991	f	18
16.	Shiten si lavire	Fl. v. 20.12	Shkup	1991	f	18
17.	Fiks vaksina	Fl. v. 20.08	Shkup	1993		
18.	Loja histori	Fl. v. 20.08	Shkup	1993		
19.	Lajmet	Tr. Sh nr.8	Shkup	1993	f	21
20.	Si valë liqeni duke u rrit	Tr. Sh nr.8	Shkup	1993	f	21
21.	Udha e	Tr. Sh nr.8	Shkup	1993	f	21

Begzat Rrahmani

22.	shkronjave Mushkëritë zgjerojnë parzmën	Fl. v. 30.01	Shkup	1994	
23.	Eshtrat bërtasin	Tr.Sh 15.02	Shkup	1994	f 21
24.	Aq më tepër	Tr.Sh 15.02	Shkup	1994	f 21
25.	Bota laramane	Fl. v. 23.06	Shkup	1994	
26.	Shpirti i trupit kufomë	Fl. v. 23.06	Shkup	1994	
27.	Gurra poetike	Fl. v. 23.06	Shkup	1994	
28.	Kataroshët	Fl. v. 23.06	Shkup	1994	
29.	Nata	Rilin. 10.07	Tiranë	1994	f 13
30.	Ringjallet vetëdija	Rilin. 10.07	Tiranë	1994	f 13
31.	Gabimi	Rilin. 10.07	Tiranë	1994	f 13
32.	Grishja	Rilin. 10.07	Tiranë	1994	f 13
33.	Matanë dardaneleve	Tr.Sh 01.09	Shkup	1994	f 25
34.	Muri makabër	Tr.Sh 11.09	Shkup	1994	f 25
35.	Vrasje bilbilash	Fl. v. 27.10	Shkup	1994	
36.	Kthjellim në ëndërr	Fl. v. 23.06	Shkup	1994	
37.	Veshka për transplantim	Tr.Sh 01.11	Shkup	1994	f 22
38.	Krongji gjaku	Flaka 23.03	Shkup	1995	
39.	Gjëmim varresh	Flaka 23.03	Shkup	1995	
40.	Lëshoni rrënjë	S.arg.12.04	Tetovë	1995	f 16
41.	Dredhitë e kohës	Flaka 22.06	Shkup	1995	
42.	Marimanga e zezë	Flaka 22.06	Shkup	1995	
43.	Luhaten rrokaqiejt	Flaka 22.06	Shkup	1995	
44.	Silueta	Flaka 22.06	Shkup	1995	

I çmendur rreth shtëpisë

45.	Hëna	Rebusi	Tetovë	13.10. 1995	f	34
46.	Lulebozhuri	Rebusi	Tetovë	13.10. 1995	f	34
47.	Ti mësoj shkronjat	Rebusi	Tetovë	13.10. 1995	f	34
48.	Bota morri zjarrin	Rebusi	Tetovë	20.11. 1995	f	34
49.	Jeta është poezi	Sup. arg.	Tetovë	20.12. 1995	f	18
50.	Jeta	Flaka	Shkup	11.04. 1996		
51.	Dritë frenqjishë	Flaka	Shkup	11.04. 1996		
52.	Xhindët e natës	Rebusi	Tetovë	Nr.5	f	31
53.	Retush varri	Rilindja	Tiranë	24.08. 1996		
54.	Amaneti	Rilindja	Tiranë	24.08. 1996		
55.	Qent e Ballkanit	Rilindja	Tiranë	24.08. 1996		
56.	Fortësia	Rilindja	Tiranë	24.08. 1996		
57.	Trupi i shkallmuar	Flaka e v.	Shkup	23.01. 1997	f	9
58.	Napranët e kohës	Flaka e v.	Shkup	23.01. 1997	f	9
59.	Qanë qetë	Flaka e v.	Shkup	23.01. 1997	f	9
60.	Lutje	Flaka e v.	Shkup	23.01. 1997	f	9
61.	Bota në ekstazë	Flaka e v.	Shkup	24.07. 1997		
62.	Dalje nga ferri	Flaka e v.	Shkup	24.07. 1997		
63.	Kulla e	Flaka e v.	Shkup	24.07.		

Begzat Rrahmani

	ëndërrave			1997		
64.	Marimanga në Paris	Flaka e v.	Shkup	30.10.1997		
65.	Amaneti	Flaka e v.	Shkup	25.12.1997		
66.	Gjeni	Vlera 23/24	Tetovë	1998	f	27
67.	Rrënjët e zisë	Vlera 23/24	Tetovë		f	27
68.	Ëndërrat sterile	Flaka e v.	Shkup	12.02.1998		
69.	Arkivoli	Flaka e v.	Shkup	12.02.1998		
70.	Mbrojtja e kullës	Flaka e v.	Shkup	12.02.1998		
71.	Çrrnjosja	Fl. janarit, 1	Kërçovë	1998	f	68
72.	Shpirti i poetit	Fl. janarit, 1	Kërçovë	1998	f	68
73.	Damar jete	Fl. janarit, 1	Kërçovë	1998	f	68
74.	Kërkesë shekujsh	Fl. janarit, 1	Kërçovë	1998	f	68
75.	Shpirti i thyer	Fl. janarit, 1	Kërçovë	1998	f	68
76.	Rrebesh moti	Fl. janarit, 1	Kërçovë	1998	f	68
77.	Hieroglifë koke	Fl. janarit, 1	Kërçovë	1998	f	68
78.	Balada e urtisë	Zëri i nxën.	Kërçovë	02.04.1998	f	10
79.	Rrugë e leckosur	Flaka e v.	Shkup	1998		
80.	Rrëmbimi	Flaka e v.	Shkup	1998		
81.	Dita e tmerrit	Flaka e v.	Shkup	1998		
82.	Rrebesh moti	Flaka e v.	Shkup	1998		
83.	Shpirti i thyer	Flaka e v.	Shkup	1998		
84.	Rreze plumbash	Flaka e v.	Shkup	21.05.1998	f	10
85.	Rob i gjumit	Flaka e v.	Shkup	21.05.1998	f	10
86.	Bota në ekstazë	Flaka e v.	Shkup	21.05.1998	f	10
87.	Grisja e natës	Stili/97, 2/3	Shkup	1998	f	143

I çmendur rreth shtëpisë

88.	Pidestali i kalbur	Stili/97, 2/3	Shkup	1998	f	143
89.	Shpirti pa fjalë	Stili/97, 2/3	Shkup	1998	f	144
90.	Merimanga	Stili/97, 2/3	Shkup	1998	f	144
91.	Bulëzimi	Stili/97, 2/3	Shkup	1998	f	145
92.	Prishja e kuptimit	Stili/97, 2/3	Shkup	1998	f	145
93.	Pushkatimi im	Stili/97, 2/3	Shkup	1998	f	146
94.	Truri i kulluar	Stili/97, 2/3	Shkup	1998	f	146
95.	Vdekjen e kemi hëngër	Stili/97, 2/3	Shkup	1998	f	147
96.	Shqiponja e ngujuar	Stili/97, 2/3	Shkup	1998	f	148
97.	Shtimi i qyqes	Stili/97, 2/3	Shkup	1998	f	148
98.	Krateri i lirisë	Stili/97, 2/3	Shkup	1998	f	149
99.	Varri i poetit	Stili/97, 2/3	Shkup	1998	f	150
100.	Mjegulla shekullore	Stili/97, 2/3	Shkup	1998	f	150
101.	Rrobet e vdekjes	Vlera, nr.27/28	Tetovë	1998	f	16
102.	Mbrojtja e kullës	Vlera, nr.27/28	Tetovë	1998	f	16
103.	Toka e gërsirë	Flaka e jan.	Kërçovë	1999	f	50
104.	Valon flamuri i bukës	Flaka e jan.	Kërçovë	1999	f	50
105.	Mbarësi i kombit	Flaka e jan.	Kërçovë	1999	f	51
106.	Ide të purpurta	Flaka e jan.	Kërçovë	1999	f	51
107.	Të vërteta të paqena	Flaka e jan.	Kërçovë	1999	f	52
108.	Truri i fëmijëve të kërrusur	Flaka e jan.	Kërçovë	1999	f	52
109.	Këngë zjarri	Flaka e jan.	Kërçovë	1999	f	53
110.	Karbonizimi i lules	Flaka e jan.	Kërçovë	1999	f	53
111.	Shpirti gjak	Flaka e jan.	Kërçovë	1999	f	54

Begzat Rrahmani

112.	gjarpëri Qielli	Flaka	Shkup	16.03. 1999	
113.	purpuronte Sharja e trurit	Flaka	Shkup	16.03. 1999	
114.	Hipnozë gjarpëri	Flaka	Shkup	16.03. 1999	
115.	Lava e shpirtit	Flaka	Shkup	16.03. 1999	
116.	Gravurë truri	Stili, nr.8-9	Shkup	1999	f 24
117.	Roja e qiellit	Doruntina 18/19	Kuma- novë	1999	f 37
118.	Jetë në gotë uji	Doruntina 18/19	Kuma- novë	1999	f 38
119.	Dallgëzim mendimesh	Doruntina 18/19	Kuma- novë	1999	f 38
120.	Shpirti gjak gjarpëri	Doruntina 18/19	Kuma- novë	1999	f 39
121.	Karbonizimi i lules	Doruntina 18/19	Kuma- novë	1999	f 39
122.	Këngë zjarri	Doruntina 18/19	Kuma- novë	1999	f 40
123.	Ide të purpurta	Doruntina 18/19	Kuma- novë	1999	f 40
124.	Mbledhja e gjymtyrëve	Stili 97	Shkup	2000	f 43
125.	Vdekja hidhërohet	Flaka e jan.	Kërçovë	2000	f 99
126.	Sumbulla lotësh	Flaka e jan.	Kërçovë	2000	f 99
127.	Epshe pa fund	Flaka	Shkup	9/10. 12.00	f 17
128.	Shtrydhja	Flaka	Shkup	9/10. 12.00	f 17

Apokalipsi (Dramë), 2001

129.	Apokalipsi	Flaka e jan.	Kërçovë	2001	f 113-
------	------------	--------------	---------	------	--------

I çmendur rreth shtëpisë

	(Dramë)					128
130.	Grisja e natë	Stili, 19/20	Shkup	2001	f	30
131.	Piedestali i kalbur					
132.	Shpirti pa fjalë					
133.	Merimanga					31
134.	Bulëzimi					31
135.	Prishja e kuptimit të ëndërrës					32
136.	Historia e grisur					32
137.	Rrobet e vdekjes					33
138.	Pushkatimi im					34
139.	Truri i kulluar					34
140.	Vdekjen e kemi hëngër					35
141.	Shqiponja e ngjuar					36
